



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:045062

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05681478

C.nr.269/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtari Durim BALAJ, duke vendosur në çështjen juridike të paditësit E.GJ., nga Republika e Shqipërisë, me banim në Tiranë, , rruga . . , kundër të paditurave, Komuna e Gjakovës dhe Zyra Kadastrale e Komunës së Gjakovës, me objekt kontesti njohjen e pronësisë, jashtë seancës, më 14 maj 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Të gjitha dorëzimet paditësit E.GJ., nga Republika e Shqipërisë, do t'i bëhen përmes afishimit-publikimit në tabelën e shpalljeve të kësaj Gjykate.

II. Dorëzimet do te konsiderohen të kryera në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e publikimit në këtë tabelë.

III. Ky Aktvendim publikohet në Tabelën e Shpalljeve të kësaj gjykate sot, më datë 14.05.2024, bashkë me aktvendimin C.nr.269/21, të datës 26.10.2023.

IV. Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

A r s y e t i m

Paditësi, në këtë gjykatë kanë paraqitur padi me datë 09.03.2021, për njohje të së drejtës së pronësisë, kundër të paditurave Komuna e Gjakovës dhe Zyra Kadastrale e Komunës së Gjakovës.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë gjeti se padia është e mangët dhe nuk mund të veprohet tani për tani sipas saj, pasi që në padi mungojnë të dhënat lidhur me zonën kadastrale dhe numrin e ngastrës kadastrale, si dhe provat materiale lidhur me ngastrën kadastrale të kërkuara.

Gjykata me qëllim të heqjes së pengesës për të proceduar tutje me trajtimin e lëndës, ka provuar që paditësit padinë t'ia kthej në plotësim për shkaqet e treguara si me lartë, duke i proceduar aktvendimin C.nr.269/21, të datës 26.10.2023, mirëpo nga fletëkthesa e dorëzuar përmes shërbimit postar të Postës së Kosovës, është dhënë konstatimi nga shërbimi postar i Republikës së Shqipërisë, se paditësi “i panjohur”.

Me nenin 116 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore Nr. 03/L-006 (LPK) është paraparë se *“në qoftë se pala ose përfaqësuesi i saj, gjatë zhvillimit të procedurës apo para se të kalojë afati prej gjashtë muajsh pas përfundimit të procedurës me vendim të formës së prerë, e ndërrojnë adresën në të cilën bëhet dorëzimi i shkresave kanë për detyrë që për këtë gjë ta njoftojnë menjëherë gjykatën.”*, tutje në paragrafin 5 është paraparë se *“në qoftë se pala apo përfaqësuesi i saj nuk e njoftojnë menjëherë gjykatën për ndryshimin e adresës, gjykata do të urdhërojë që dërgimet e mëtutjeshme të shkresave të bëhen me anë të afishimit të tyre në tabelën e shpalljeve në gjykatë. Kjo mënyrë e komunikimit bëhet deri sa pala apo përfaqësuesi i saj ta njoftojë gjykatën për adresën e re të saj.”*, ndërsa në paragrafin 6 është paraparë se *“Komunikimi nga paragrafi 5 i këtij neni konsiderohet i kryer pas kalimit të shtatë ditëve nga dita e afishimit të shkresës në tabelën e shpalljeve të gjykatës”*.

Pasi që gjykata nuk ka mundësi që palës paditëse t'ia dërgoj aktvendimin C.nr.269/21, të datës 26.10.2023, në kuptim të dispozitës së nenit 116 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, e cila ka paraparë detyrimin e palës që të informojë gjykatën për ndërrimin e adresës ku i janë dërguar shkresat e gjykatës, vendosi që konform nenit 116 paragrafi 5 dhe 6 të Ligjit të procedurës Kontestimore, paditësit komunikimi i shkresave t'i bëhet përmes afishimit të tyre në tabelën e shpalljeve në gjykatë.

Nga të lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.269/21, me 14 maj 2024

GJ Y Q T A R

Durim BALAJ